

Kalitja në Natyrë

Skemë Ide

Daljet në natyrë me nxënësit e arësimit parauniversitar

Në çdo fushë të jetës synimet që duam të arrijmë janë të lidhura me një filozofi të caktuar (thënë ndryshe - me bindje të caktuara) e cila bëhet udhëheqje për veprim.

Filosofia jonë alias Bindjet tona

Qëniet njerëzore janë pjellë e natyrës dhe si të tilla natyrën e kanë patur dhe e kanë vatrën genetike të egzistencës së tyre.

Zhvillimi ekonomik dhe teknologjik e ka shkëputur ndjeshëm njeriun nga natyra.

Për të afruar sado pak njeriun me natyrën sistemit arsimor i del për detyrë që të edukojë në mënyrë të pandërprerë brezin e ri me veprime jetësore dhe akademike në natyrë.

Për këtë:

Arsimimi dhe edukimi i brezit të ri të lidhen me veprime e praktika konkrete në natyrë.

Natyra të jetë pjesë e jetës së rinisë sonë për kalitje dhe argëtim.

Andaj:

Kurikulat shkollore të përmbajnë harmonizim të njohurive të reja dhe të ripërtërira me praktika (punë laboratorike) në natyrë duke i zgjithur ato në vendet më tipike që përputhin teorinë me praktikën.

Kurikulat shkollore të përmbajnë tema që lidhen me daljet në natyrë dhe me edukimin nëpërmjet saj, me argëtimet në natyrë si dhe me mbrojtjen e natyrës (të jetojmë, të arsimohemi dhe të argëtohemi në natyrë pa lënë gjurmë).

Natyrë si terren jo vetëm për kalitje

Në kohët tona asnjë segment i jetës nuk mund të trajtohet i shkëputur nga segmentet e tjera të saj.

Qartësim: Udhëtimi më këmbë nga rruga nacionale Tiranë – Elbasan për në Fortesën e Petrelës.

Në rrëzë të kodrës ku ngihet fortesa shohim fusha ku mbillen produkte të ndryshme bujqësore. Përgjatë ngjitjes për në fortesë shohim pyll me mare, shqipë, etj., si dhe drurë ulliri të cilët zënë sipërfaqet jashtë rrethojave të banesave. Rrethojat e banesave përmbajnë, veç banesës, fruta të ndryshme dhe perime. Qyteza është e përqëndruar në kreshtë të kodrës kurse fortesa në pikën më të lartë të kreshtës përëndimore të saj. Rruga e gjërë ndërpritet teksa fillon ngjitja nga qendra e qytezës për në fortesë.

Një nxënës që ka dalë me mësuesen/in e tij për qëllime kalitëse (për tu ngjitur deri në fortesë), do e ketë të fotografuar paragrafin qartësues. Sot edukatorëve/mësuesve u duhet që të “mjelin” sa më shumë dije nga ky paragraph plot njohuri nga fusha të ndryshme të dijes dhe t’i komentojë (ka shumë rëndësi që për hir të dijeve të komentohet e diskutohet gjatë marshimit) ato me nxënësit pak-a-shumë si ma poshtë.

Si ta lexojmë paragrafin?

Shkurtimisht: kodra ku ngjitemi ka pyll të tipit mesdhetar (makia) ku fare mirë në të gjithë vendin tonë rritet druri i ullirit. Moshë e drurëve të ullirit tregon se të parët e këtyre anëve ja kanë lënë kodrën ullirit dhe banesës dhe fushën poshtë prodhimeve të tjera bujqësore. Secili banor i njeh drurët e tij të ullirit (ata nuk janë të shënuar); ullinjtë (prodhimi) nuk vidhen gjë që e tregon mungesa e rrethimit të ullishtave (ndryshe nga frutat e tjera dhe banesat që janë të rrethuara). Rruga e gjërë, mbi të cilën është ndërtuar rruga automobilistike, tregon se dikur qyteza ka komunikuar, veç kafshëve të barrës, me qerre. Rruga e ngushtë për të dalë në fortesë tregon se fortesa ka shërbyer si repart ushtarak, me gjasë për të kontrolluar rrugëkalimet në luginën e lumit Erzen, ku hynin e delnin kalorës. Fakti që fortesa nuk është në pikën më të lartë të kodrës bashkëngjitur me fortesën tregon se të kontrollosh një zonë, për të parët tanë, nuk ka qenë e nevojshme që të dalësh në pikën më të lartë të relievit, por ka patur rëndësi të dalësh (të ngreshë fortesën) në atë pikë ku kontrollohet ajo që duhet kontrolluar duke kursyer njëkohësisht kohë (me ngjitjet e zbritjet fortesë-luginë). Kronikat flasin se kjo fortesë si dhe kështjellat në Prezë dhe Krujë e shikonin njëra tjetrën dhe komunikonin mesazhe të karakterit ushtarak me zjarr dhe tym.

Pra leximi i paragrafit, na tregon se *itenerari i një marshimi, nëpërmjet të cilit realizojmë kalitjen fizike*, mbart njohuri nga fusha të ndryshme të jetës. Mësuesi nuk mundet të marrë përsipër të komentojë gjithshka që fotografohet në një itenerar.

Andaj, sistemi arësimor duhet të bashkëpunojë me specialistë të fushave të ndryshme të shkencës dhe jetës që të integrohen njohuritë e “shkuara” në një itenerar në një paketë njohurish. Kjo të bëhet në çdo njësi administrative vetëm për disa itenerarë të cilët do të shërbejnë si modele mësimore me qëllimin që nxënësi që del në natyrë për qëllime argëtuese të mësojë se si t’i marrë ekskursionit/marshimit sa më shumë vlera (kur i përvehtësojmë njohuritë që na shfaq natyrë ne fatmirësisht argëtohem!).

Cekje lidhur me kurikulën shkollore

Shfrytëzimi i fundjavës për dalje në natyrë (det, kodër, lumë, mal, çiklizëm, ski, etj.) ja vlen që të mishërohet në kulturë familjare dhe më gjërë. Pa dyshim që një qytetar i shlodhur në fundjavë do të jetë një qytetar i cili i jep gjatë javës së re shoqërisë më shumë në çdo fushë të punës dhe studimit. Që kjo kulturë të ngizet në familjet tona shkolla duhet të luaj rol pararojë. Kjo, ndër të tjera, arrihet nëse argëtimet në natyrë do jenë pjesë e kurikulës shkollore, sikundër janë lëndët e tjera të programit mësimor.

Disa nga temat që duhet të përfshijë kurikula (të dhëna për qëllim qartësues):

- Busulla turistike e institucionit arsimor (kopshti apo shkolla)
- Veshja në daljet në natyrë sipas llojit të veprimtarive që mendohet të ndërmerren.
- Ushqimi që përdoret në këto veprimtari (i gatëshëm apo që përgatitet në vendin ku shkojmë).
- Pajimet e veçanta që kërkon veprimtaria që ndërmerret.
- Rregullat e ecjes.
- Ndërtimi i një fushimi dhe kalimi i natës në natyrë.
- Higjena vetiake dhe higjena kolektive gjatë qëndrimit në natyrë.
- Përse na duhen dhe përse duhet të mbrojmë dhe të kujdesemi për shenjat e vendosura si orientuese të itinerarëve të marshimeve, biçikletave, skijimit, etj., në natyrë.
- Etika e sjelljes ndaj natyrës mbështetur në moton ‘të argëtohemi në natyrë pa lënë gjurmë’.

Ligje dhe integritime

Në një afat kohor sa më të afërt, ndërtimi i kulturës së argëtimit në natyrë duhet të shoqërohet me ligje të llojit VKM si dhe me bashkëpunime ndërministrorë (arsimi, kultura, turizmi, mjedisi, bujqësia, etj.).

Njësitë administrative (të ndarjes së re territoriale) duhet të ndajnë (alokojnë) fonde të veçanta për shënjimin e itinerarëve për bjeshkim, udhëtime në natyrë, dhe veprimtarive të tjera sportive. Njësitë administrative të krijojnë një 'këshill turistik' i cili ndër të tjera duhet të ketë një plan ku të përcaktohet për çdo vit se cilët itinerarë për veprimtaritë në natyrë do të shënohen dhe cilët itinerarë të shënuar më parë do të mirëmbahen apo përmirësohen.

Njësitë administrative duhet të ndërtojnë busullat turistike të daljeve në natyrë për nxënësit e arësimit parauniversitar si dhe ato të vlerave kulturore, historike, etj., të qëndrave të banuara dhe më gjërë për qëllime turistike.

Integritime ndërministrorë

Me qëllim që natyra të ketë qasje për këdo dhe kudo ku është e mundur (e pamundur për zonat ushtarake, zonat e ndotura dhe me rrezikshmëri) duhet të ketë bashkëpunim ndërministror dhe vendime qeveritare (të llojit VKM) për tema si ma poshtë:

Parqet kombëtare (p.sh. Parku Kombëtar Dajt) të jenë parqe ku **nuk** tregtohet mish dhe alcohol.

Fermat, plantacionet me pemë frutore, vreshtat, etj., të jenë blloqe me mundësi që të përshkohen në rrugë të paracaktuara nga biçiklistat, vrapuesit, ekskursionistët, hipistët.

Të ketë përcaktim në lartësi (metra mbi nivelin e detit) ku të lejohen dhe të mos lejohen lokalet dhe shërbimet. Nëse nuk i vihet kufi shërbimeve do cënohen industritë që prodhojnë artikuj turistikë (veshje, mbathje, konserva, tenda, etj.).

Busullat Turistike

Me busull turistike do të kuptojmë një tabelë ose një skicë ku sipas një kriteri të paracaktuar janë hedhur vendet me rëndësi në një qendër banimi dhe/ose në natyrë (pa zbatuar kriterin e orjentimit rigoroz me horizontin apo sistemin e shkallës (cm në letër – metra në terren) si në një hartë.

Çdo njësi administrative duhet të ketë busullën e saj turistike ndërtimi i së cilës ja vlen të jetë detyrë e një (le ta quajmë) këshilli turistik dhe e zyrës së informacionit turistik të saj.

Çdo institucion arësor i njësisë administrative duhet të ketë busullën e vet turistike të bazuar në busullën turistike të njësisë administrative ku bën pjesë si dhe, sipas rasteve, edhe të një pjese të elementëve të busullave turistike të njësisë administrative fqinje.

Çdo institucion, për ndërtimin e busullës turistike duhet të nxjerrë në pah vendet me rëndësi për tu vizituar (i quajtmë dukáte në këtë material). Për qartësim po përmbledhim më poshtë në formën e tabelave disa vende me rëndësi në brendësi të qytetit të Tiranës dhe të periferisë së afërt të saj. Këto tabela nuk janë përfundimtare, janë qartësuese, dhe ka vend për korrigjime dhe shtesa.

Çdo kopësht dhe çdo shkollë të ketë minimalisht, për çdo vit shkollor, dy veprimtari të daljeve në natyrë. Këto veprimtari të shihen si kurikulë shkollore dhe i gjithë stafi i tyre (jo vetëm mësuesit e edukimit fizik) të përvehtësojë organizimin e tyre.

DUKATET e Qytetit të TIRANËS


Me fjalën dukat (shumësi: dukatet) do të kuptojmë një vend me rëndësi (që duket për nga rëndësia që ka).

Nr.	Dukati	Përshkrim i thjeshtuar	Verejtje
01	Sheshi Skënderbej	Qëndër e Tiranës, ku ndodhet TOB, Biblioteka Kombëtare, etj.	
02	Xhamia “Et’hem Bej”	Vepër kulturi e ndërtuar në vitin 1789	
03	Hotel “Dajti”	Hotel i dikurshëm i cili deri në fund të shekullit të kaluar ishte simbol luksit dhe i destinuar kryesisht për vizitorë të huaj	
04	Parku Rinia	Qëndër veprimtarishë kulturore dhe artistike, vendi ku gjendet “kryeqyteti” i kafeneve shqiptare, Taiëan.	
05	Muzeu Arkeologjik	Muze i ndërtuar pas LIIB me inventar prej rreth 2.000 objekte	
06	Akademia e Arteve	Qëndër studimore për artet. Në të ndodhet salla me cilësitë më të mira akustike në Shqipëri.	
07	Kopshti zoologjik	I ndodhur në skalin jugor të digës së Liqenit Artificial është qendra më e madhe e vendit ku ekspozohen kafshë të ndryshme.	
08	Blloku	Një kompleks ndërtesash, dikur vetëm dykatëshe, ku jetonte udhëheqja e regjimit enverist.	
09	Friend’s Book House	Një kafene dhe çajtole letrare me një numur të madh librash dhe albumesh.	
10	Rruga e Ambasadave	Një rrugë me bukuri arkitektonike dhe ekologjike ku janë përqëndruar një numur i konsiderueshëm përfaqësishë diplomatike	
11	Muzeu Kombëtar	Qendër me rëndësi përparësore në historinë dhe kulturën shqiptare	
12	Biblioteka Kombëtare	Bibliotekë e pasur me libra e materiale informative. Aty ka edhe një qendër të veçantë me libra dhe informacione në gjuhën angleze.	
13	Teatri Kombëtar	Institucioni më i rëndësishëm teatral në vendin tonë. Shfaqet e para teatrale në Shqipëri filluan më 1874.	
14	Kinemaja Millenium	Kinema e standardeve të kohës. Filmi i parë në Shqipëri u shfaq në vitin 1913.	
15	Biblioteka e Vjetër Kombëtare	Godinë e rëndësishme historike e Tiranës e ndërtuar më 1908. Në sheshin para saj u ngrit Flamuri Shqiptar më 26.11.1912.	
16	Piramida	Qendër me rëndësi kulturore dhe mediatike.	
17	Shoqata Kulturore “Robert Shëartz”	E ndodhur në “Blok” shërben si pikë takimi për qytetarët që tregojnë interes për kulturën gjermane.	
18	Stadiumi Kombëtar	Qendër me rëndësi sportive për atletikë dhe futboll.	
19	Stadiumi Stërmasi	Qendër me rëndësi sportive kryesisht për futboll. Selia e Klubit Sportiv Tirana.	
20	Qyteti Studenti	Lagje e Tiranës ku jetojnë rreth 14.000 studentë universitarë.	
21	Tregu i Ri	Tregu (Pazari) i Ri i Tiranës është qendër e rëndësishme tregtare e ‘hapur’ ku tezgat me mallra janë dominuese.	
22	Parku i Madh	Park që ndodhet në kodrat jugore të Tiranës dhe që bashkë me Liqenin Artificial krijojnë vendin më të populluar për daljet në natyrë të tiranaseve.	

DUKATET e periferisë së Qytetit të TIRANËS

Nr.	Dukati	Përshkrim i thjeshtuar	Verejtje
01	Fortesa e Ndroqit	Ndërtim i periudhës Romake	
02	Fshati Pezë	Vendbanim i hershëm dhe qendër e njohur historike gjatë LIIB	
03	Ura e Beshirit	Vend tipik në lumin Erzen që pasqyron barbarrinë ekologjike gjatë 25 viteve të fundit	
04	Arbanë	Vendbanim i hershëm; ekspozitë natyrale e ditëve tona për bujqësinë përgjatë lumit Erzen	
05	Petrelë	Qendër banimi dhe fortesë që daton nga periudha antike	
06	Kështjella e Përsqopit dhe varret Ilire	Qendër arkeologjike e antikitetit me eksplorim të pa përfunduar	
07	Shpella e Pëllumbasit	Shpellë me gjurmë të banimit të arinjeve dhe njerëzve 10-50.000 vjet më parë	
08	Mali i Priskës	Mal me vlera për ekskursione në horizontin lindor të Tiranës	
09	Kreshta e Dajtit	Kreshtë panoramike që siguron shikim si të Shqipërisë Bregdetare ashtu edhe të Shqipërisë Qëndrore	
10	Mali i Dajtit	Vend turistik prej nga mund të ndërmerren itinerarë të ndryshëm për lehtëza dhe argëtime	
11	Kanionet e Brarit	Pjesë e Lumit të Tiranës ku soditen fenomenet e erozionit të ujit në formacionet shkëmbore të malit të Dajtit.	
12	Shkalla e Tujanit	Segment i rrugës së Arbërit ndërtuar në antikitet që lidhte Shqipërinë Bregdetare me Shqipërinë Qëndrore dhe Lindore.	
13	Rezervuari i Burvillës	Zonë e brëndëshme e Tiranës (e pasmalit) ku sigurohet një pjesë e konsiderueshme e ujit të pijshëm të kryeqytetit	
14	Kurora Jugore e Tiranës	Një udhëtim nëpër kreshtat e kodrave Selitë - Sauk nga ku sodisim luginën e lumit Erzen, qytetin e Tiranës dhe vargun malor Krujë - Kërrabë.	
15			
16			
17			

Variant me Skicë i Dukateve të Periferisë së Tiranës



DUKATET E PERIFERISE SE QYTETIT TE TIRANES

Kualifikimi i Mësuesve për daljet në Natyrë

Daljet në natyrë nuk duhet të jenë detyrë vetëm për Mësuesit e Fizikulturës. Sigurisht që ata do jenë kryesorët në një institucion arësor për njohuritë në fushën në fjalë. Dhe që të jenë të tillë, përgatitja e tyre nga Universiteti i Sporteve duhet rishikuar i lidhur me kurikulën aktuale universitare, gjë që i takon Drejtorisë së Arësimit të lartë, dhe jo ne, që të ndërhyjë në përditësimin e programeve. Kjo është (apo duhet të jetë) temë më vehte, por nga përvoja shumëvjeçare në sport marrim kurajo që të rendisim tre parasyshje për këtë institucion:

- Ka patur mungesë literature, dhe për pasojë pamjaftueshmëri në orë leksionesh, për sportet malore (ski, alpinizëm, turizëm).
- Ka patur dobësi të theksuar në bazën material për praktikat e studentëve lidhur me sportet malore.
- Askurrë nuk ka patur instruktorë (pedagogë) të stafit që të kenë patur një emër sado të vogël si sportistë në sportet malore.

Kurikulat e përgatitjes së mësuesve, të të gjitha kategorive, nga institucionet e larta arësimore duhet të kenë tema lidhur me kulturën sportive në përgjithësi si dhe lidhur me daljet në natyrë në veçanti. Duke patur parasysh se çfarë duam të arrijmë me nxënësit për çdo vit akademik, në kopështe, ciklin fillor e deri në klasën e 12-të, duhet të ndërtohet edhe kurikula e përgatitjes së mësuesve për veprimtaritë sportive dhe për daljet në natyrë.

Në ciklin e kualifikimit të mësuesve për ruajtjen e vendit të punës dhe/ose për rritjen e tyre në kategori, programi i provimeve/testimeve duhet të përmbajë lëndë e leksione kualifikuese edhe për temën në fjalë.

Ministrisë së Arësimit dhe Sporteve i sygjerojmë që të bashkëpunojë me institucione të ndryshme për të prodhuar filma, botime, fletpalosje, fotoekspozita, etj., të cilat përcjellin kulturën e veprimtarive në natyrë (krahas fushave të tjera).

Lidhur me tema emergjente për sa ma sipër bashkëpunimi i MAS-it me federatat sportive në sporte të caktuara duhet të vendoset sa ma parë. Kjo të shihet si një nevojë 1-2 vjeçare, kohë që e mendojmë të mjaftueshme që institucionet e larta arësimore dhe kualifikuese të ristrukturojnë misionin e tyre.